



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 197/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër Bekim Troni në cilësinë e Drejtorit të Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit në Komunën e Kaçanikut, për shkak të parregullsive gjatë procesit të zgjedhjeve në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06. 2012, mori këtë:

#### V E N D I M

I. Pretendimet ankimore nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për sa i përket këtyre çështjes së Bekim Tronit se e ka kryer punën e Menaxherit të Qendrës së Votimit (QV) 0719D, **refuzohen si të pabazuara.**

II. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se emërimi i Bekim Tronit në cilësinë e zyrtarit të tavolinës ndihmëse në QV0719D, nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) është bërë pa bazë ligjore, PZAP **shpallet inkompetent** në këtë çështje juridike.

#### Arsyetim

PZAP-i, më datë 18.06.2012, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, dega në Kaçanik, me të cilën pretendohet se me datën 17.06.2012 në QV0719D Bekim Troni, në cilësinë e Drejtorit të Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit në Komunën e Kaçanikut ka kryer rolin e menaxherit të QV0719D në shkollën “Idriz Seferi” në fshatin Kovaqec, dhe se emërimi i personit në fjalë në cilësinë e menaxherit të QV është bërë pa bazë ligjore.

Pala ankuese kërkon nga PZAP-i që të kërkoj nga KQZ-ja mënyrën dhe bazën ligjore të emërimit të personit të sipërshënuar.

PZAP-i, e informoi nëpërmes shkresës 197/2 datë 18.06.2012 KQZ-ën lidhur me ankesën. Në përgjigje ndaj ankesës së sipërshënuar KQZ-ja e ka dërguar në PZAP listën e Menaxherëve të QV-ve në Komunën e Kaçanikut.

PZAP më datë 20.06.2012, ka kërkuar nëpërmes telefonit deklaratën nga Menaxherja e QV 0719D Florije Zeneli, e cila deklaratë është incizuar me lejen e menaxheres, në

të cilën theksohet se Bekim Troni, nuk ka qenë menaxher në QV 0719D, por ka qenë i caktuar në tavolinën ndihmëse. Sipas deklarueses Bekim Troni në këtë pozitë është zgjedhur për arsye se 2 (dy) punëtor tjerë kanë qenë të moshuar dhe nuk kanë qenë të interesuar të kryejnë këtë punë. Menaxherja e QV 0719D më tej thekson se KQZ-ja e as dikush tjetër nuk kanë pas ndonjë ankesë lidhur më këtë, ne i kemi dorëzuar në KQZ dokumentet dhe nëse ata e kanë certifikuar gabim nuk është problem i imi.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se pretendimet ankimore sa i përket çështjes se Bekim Troni e ka luajtur rolin e Menaxherit të QV0719D, **janë të pabazuara.**

Në ankesë theksohet se Bekim Troni në cilësinë e Drejtorit të Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit në Komunën e Kaçanikut e ka kryer punën e Menaxherit të QV 0719D dhe është emëruar nga KQZ-ja në këtë pozitë pa bazë ligjore. PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se personi në fjalë nuk e ka kryer punën e Menaxheri QV 0719D, kjo shihet në provat e ofruara nga vetë pala ankuese në të cilat personi në fjalë është i caktuar si zyrtar në tavolinën ndihmëse e jo në listën e menaxhereve të QV të cilën e vërteton edhe KQZ-ja me listën e emrave të cilët kanë qenë ta caktuar në detyrën e Menaxherit të QV nga e cila vërtetohet saktë se emri i personit në fjalë nuk gjendet në listë si menaxher i QV 0719D.

Prandaj pretendimet e tilla të ankesës u vlerësuan si të pa baza dhe të pa argumentuara me prova dhe dëshmi bindëse, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi.

Për pretendimet ankimore se si është bërë përzgjedhja e Bekim Tronit në cilësinë e Drejtorit të Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit në Komunën e Kaçanikut, që ta kryej punën e zyrtarit të tavolinës ndihmëse, PZAP **shpallet inkompetent në këtë çështje juridike, pasi që në Nenin 64 paragrafi 2 pika "f"** të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) është paraparë se KQZ-ja *akrediton vëzhguesit dhe zyrtarët e zgjedhjeve kështu që kjo çështje është përgjegjësi e KQZ dhe PZAP-i në këtë drejtim dhe për këtë çështje ndaj KQZ-ës nuk ka kompetenca.*

Sipas nenit 122 paragrafi 1 të LZP-së përcakton se: *Personi Fizik ose, të drejtat e të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apeloj atë vendim në PZAP brenda njëzetekatër (24) orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet të vendoset nga PZAP- brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve, pasi të jetë parashtruar apeli.*

Sipas neni 64 par. 2 pika "f" KQZ-ja, është përgjegjëse për certifikimin e zyrtarëve zgjedhorë, për këtë arsye PZAP-i shpallet inkompetent siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi ndërsa për bazën ligjore që kërkon pala ankuese se si është bërë emërimi i Bekim Tronit në cilësinë e zyrtarit të tavolinës ndihmëse, është përgjegjëse KQZ-ja ta sqaron.

Në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 197/2012 më datën 21.06.2012.

**Kryesuesi i panelit  
Ymer Hoxha**

